



KA.nr..168/2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Zekaj kryetare, Ramiz Kuqi dhe Ragip Namani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale-procesmbajtëse , duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Imri Hashani nga fsh. Mirashë K.Ferizaj, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj, Nr. regj. 11541/2012 , të dt. 13.11.2012, në bazë të nenit 31 al. 3, 39 dhe 216 al. 2 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 08.03.2013 merr këtë:

#### A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË ankesa e paraqitur nga i pandehuri Imri Hashani nga fsh. Mirash,si e palejuar në vështrim të nenit 216 al. 2 të Ligjit mbi kundërvajtjet.  
Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve ne procedurë.

#### A R S Y E T I M

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj, me aktvendimin Nr. regj. 11541/2012 të dt. 13.11.2012 të pandehurin: Imri Hashani, nga F. Mirash e ka shpallur përgjegjës sepse: deri më dt. 31 mars të vitit 2012 nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë në cilësinë e këshilltarit Komunal të Komunës së Ferizajt.

- me çka, kryer kundërvajtje nga neni 5 dhe neni 6 par.1 pika 1 dhe 2 të ndëshkueshme me nenin 17. par. 1 pika 1.2 Ligjit Nr.04/L-050, andaj në vështrim të nenit 9 të LK është dënuar me gjobë në shumë prej nga 400 (katërqind) Euro.

Me të njëjtën aktvendim i pandehuri është të obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga 5 (pesë) Euro.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Imri Hashani, ka paraqitur ankesë, për shkak të: vërtetimit të gabuar të gjendjes, me arsyetim se nuk janë të vërteta pohimet e dëshmitarëve se i kemi pranuar individualisht formularët për deklarin e pasurisë. Po sa jam informuar për këtë obligim ligjor, të nesërmen e kam paraqitë. Se kundërvajtjen nuk e kam bërë me qellim nga se nuk kam qka të fsheh sepse jam punëtor i arsimit dhe i mbaj 7 anëtarë të familjes.I propozon Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, që aktvendimin e goditur ta anuloh dhe ta liroj nga dënimi me të holla.

Kolegji i kësaj gjykate duke vlerësuar ankesën, aktvendimin e goditur dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi sipas detyrës zyrtare se ankesa e paraqitur është e palejuar.

Nga provat e deponuara dhe të administruara, Kolegji i kësaj gjykate konstatoi se ankesa e paraqitur nga i pandehuri Imri Hashani , është e pasafatëshme, pasi që nga shkresat e lëndës (fletë dorëzimi) konstatohet se aktvendimi është pranuar më dt. 08.12.2012, kurse ankesa është paraqitur më dt. 18.12.2012, e që është dashtë të paraqitet në afatin ligjor prej 8. ditësh., nga dita e pranimit të aktvendimit dhe pasi që ankesa është paraqitur pas afatit ligjor, konsiderohet si e palejuar, gjë që gjykata e shkallës së parë konform të nenit 216 al. 1 të Ligjit mbi kundërvajtjet, ka qenë i obliguar ta hudhë poshtë ankesën si të pa lejuar.

Pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar siç u cekë më lartë, Kolegji i kësaj gjykate në vështrim të nenit 216 al. 2 të LK, e hudhë poshtë ankesën si të palejuar, andaj vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.  
Kundër këtij aktvendimi nuk ka vend ankese.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË  
KA.168/2013 të dt. 08.03.2013

Procesmbajtësja,  
Sebahate Hoti



KRYETARJA E KOLEGJIT,  
Mejreme Zekaj

*[Handwritten signature]*